

**HYRJE NË RAPORTIN E DEPARTAMENTIT TË SHËTETIT
TE SH.B.A. MBI TRAFIKIMIN E PERSONAVE
PËR VITIN 2002
05 QERSHOR 2002**

RAPORTI

Ky është raporti i dytë i përvitshëm për Kongresin, siç kërkohet nga Akti, mbi statusin e formave të ashpra të trafikimit të personave në mbarë botën. Raporti mbulon periudhën Prill 2001 deri në Mars 2002. Në raportin e këtij viti, një numër vendesh janë zhvendosur nga grupet ku ishin përfshirë vitin e kaluar, siç diskutohet në faqet 14 dhe 15. disa vende nuk janë radhitur në raportin e këtij viti për shkak të mungesës së informacionit të besueshëm, siç diskutohet në faqet 13 dhe 14. Me anë të këtij raporti vjetor, Shtetet e Bashkuara synojnë të tërheqin vëmendjen ndërkombëtare, si të qeverive ashtu dhe të publikut të gjerë, ndaj praktikës së tmerrshme të trafikimit të personave. Ky raport shërben si një mjet i rendësishëm diplomatic për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara, e cila shpreson që qeveritë e tjera do ta konsiderojnë si një instrument për dialog të vazhduar, nxitje të punës së tyre aktuale, si dhe si një instrument për t'i ndihmuar ato që të përqëndrojnë punën e tyre të ardhshme mbi ndjekjen penale, mbrojtjen dhe programet e politikave të parandalimit. Pas nxjerrjes së raportit të këtij viti, Departamenti do të vazhdojë të angazhohet në diskutime me qeveritë mbi përmbajtjen e raportit për të ndihmuar forcimin e përpjekjeve bashkëpunuese për të çrrënjësuar trafikimin. Departamenti do të përdorë informacionin e përftuar në hartimin e raportit të këtij viti për të drejtuar programet e asistencës në mënyrë më të efektshme dhe për të punuar me vendet që kanë nevojë për ndihmë në luftën kundër trafikimit. Së fundi, Departamenti shpreson që raporti do të jetë një mjet për përpjekjet e qeverive për të luftuar trafikimin e personave në mbarë botën me qëllim që kjo praktikë poshtëruese të eliminohet.

Metodologjia

.....

Shqipëria (Grupi 2)

Shqipëria është një vend origjine tranzitimi kryesisht për gratë dhe vajzat të trafikuar për qëllime shfrytëzimi seksual në Itali dhe Greqi, dhe për në vende të tjera të BE, si Belgjika, Franca, dhe Holanda. Viktimat që kalojnë tranzit në Shqipëri vijnë kryesisht nga Rumania dhe Moldavia, dhe në numër më të vogël nga Bullgaria dhe Ukraina. Gjithashtu, raportohet të ketë edhe djem të vegjël që trafikohen nga Shqipëria si lypës në Itali dhe Greqi.

Qeveria Shqiptare ende nuk përmbush plotësisht standartet minimale për eliminimin e trafikimit; sidoqoftë, po bën përpjekje domethënëse për një gjë të tillë. Kodi Penal e ndalon trafikimin. Megjithë mungesën e theksuar të burimeve, Qeveria ka arrestuar 96 persona për krime trafikimi nga dhjetori 2000 deri në tetor 2001, dhe shpeshtësia e arrestimeve vazhdon të rritet. Nga këto, ka pasur të paktën 12 dënime, nga të cilat

9 kanë marrë burgim minimal. Prokurorët fajësojnë shkallën e ulët të dënimit në bazë të mungesës së fakteve. Me përjashtim të tre personave të dënuar në mungesë për trafikimin e personave në shkurt 2002, të gjitha dënimet deri më sot janë dhënë për akuza të reduktuara të tilla si përkrahje e prostitucionit. Trafikimi hetohet nga Sektori i Antitrafikimit dhe Sektori i Krimit të Organizuar. Megjithatë, korrupsioni i policisë pengon përpjekjet anti-trafikim. Zyra e Kontrollit të Brendshëm heton pjesëmarrjen e policisë, por sipas një studimi nga organizata ndërkombëtare, 10 përqind e viktimave të huaja të trafikuar nëpërmjet Shqipërisë raportuan se policia kishte qenë e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pak policë apo zyrtarë qeveritarë ndiqen penalisht. Në planin rajonal, qeveria bashkëpunon me qeveri të tjera nëpërmjet një organizate ndërkombëtare dhe shkëmbeu informacion mbi 15 çështje të trafikimit në vitin 2001. Në lidhje me mbrojtjen, policia nuk i trajton më viktimat si kriminelë dhe në mënyrë rutinë i drejton viktimat tek strehat e OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare. Me ndihmën e OJQ-ve dhe bizneseve vendase, shefat e policisë në Fier dhe Durrës ngritën brenda prefekturave të tyre streha të përkohshme për mbrojtjen e dëshmitarëve. Megjithatë, qeveria nuk ka një program të gjithanshëm për mbrojtjen e dëshmitarëve. Nuk ka përpjekje parandalimi të sponsorizuara nga qeveria, por Sektori i Anti-Trafikimit po përgatit

një studim mbi modelet dhe metodat e trafikimit, i cili mund të ndihmojë në strategji parandaluese të të ardhmes.